



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 34  
Prishtinë, më 12. 05. 2009, ora 13:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

**Munguan:** Ismet Beqiri - kryetar dhe Luljeta Shehu, që ishin në udhëtim zyrtar.

**Të ftuar:** Nga Agjensioni Kosovar i Pronave, Beshir Islami dhe Esat Kelmendi, nga Rektorati Muhamet Shala - parashtues i ankesës.

**Kryesuesi** - I njoftoi të pranishmit se në punimet e mbledhjes së Komisionit merrte pjesë **Driton Tali** - deputet i pavarur i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Mbledhjen e mbikëqyrën:** Rrezarta Ahmeti - KDI dhe përfaqësuesi i OSB-ës.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

Mbledhjen e kryesoi: Hajredin Hyseni dhe propozoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
2. Dëgjimi i përfaqësuesve të Agjencionit Kosovar të Pronës dhe të Rektoratit lidhur me ankesën që ka të bëjë me çështjen banesore,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i letrës së bardhë “Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë”, që bashkë me rekomandimet i dërgohen Komisionit FunkSIONAL,
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** - Konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

## 1 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Pas konstatimit të kryesuesit procesverbali u miratua.*

## 2. Dëgjimi i përfaqësuesve të Agjencionit Kosovar të Pronës dhe të Rektoratit lidhur me ankesën që ka të bëjë me çështjen banesore

**Hajrendin Hyseni** - kryesues – I përshëndeti të ftuarit që iu përgjigjen ftesës: Beshir Islami - nga Agjencioni Kosovar i Pronave, Esat Kelmendi - nga Rektorati, si dhe Muhamet Shala nga Prishtina. Ai ua përkujtoi të pranishmëve se në mbledhjen e kaluar Komisioni e kishte dëgjuar Muhamet Shalën për ankesën e kontestimit të pronësisë së banesave, që Rektorati ua kishte dhënë në vitin 2000, prandaj kishte vendosur t'ju ftonte dhe ta njoftonte Komisioni për procedurat. Ai e ftoi përfaqësuesin e Agjencionit Kosovar të Pronave që ta merrte fjalën.

**Beshir Islami** – Në vija kryesore e paraqiti rolin që ka pasur Agjencioni për vendosjen e popullsisë së zhvendosur. Tha se më vonë u themelua Drejtorati për Çështje Pronësore, Banesore, që ka pasur mandat të merrej me pronat e humbura banesore.

Në këtë kontekst e paraqiti kronologjinë e zhvillimit dhe i ceku tri arsye: *E para*, si pasojë e konfliktit, që ka ndodhur në Kosovë pas 24 marsit deri në përfundimin e bombardimeve të NATO-s. Në këtë grup bëjnë pjesë 98% e kërkesave. *E dyta* kërkesat e atyre që kishin të drejtë banesore, që pas 24 marsit 1989 e kanë humbur të drejtën, si pasojë e diskriminimit. *E treta*, kategoria e kërkesave që kanë hyrë në transaksion ndërmjet tyre me vullnet të lirë. Mirëpo ligji i atëhershëm nuk i lejonte t'i regjistronin në kadastër dhe në gjykatë. Ankuesi ka paraqitur kërkesë më 2001 dhe mendonte se e kishte humbur kundër dëshirës banesën në Lagjen Universitare, që sipas dokumenteve ia kishte dhënë ish - Drejtoria e atëhershme e Fondit për Zhvillim e Ndërtim, që t'u siguronte banesa kuadrove që punonin në Universitet. Pra, Muhamet Shala – ka dokumente nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës, sipas të cilave i është dhënë banesa për shfrytëzim në vitin 2000. Drejtorati këto lëndë ia ka dërguar Komisionit të Ankesave Pronësore – Juridike. Në këtë rast konstatoi se objekti ishte regjistruar në emrin e Predrag Lekiqit, të cilit vendosi t'ia kthente në shfrytëzim. Ndaj ankuesit janë zbatuar dispozitat e nenit 6 të Rregullores së UNMIKU-t nr. 2000/60, që ua mori të drejtën dhënësve të banesave t'i kishin në dispozicion banesat që nuk janë privatizuar. Ky është shkak i refuzimit të vendimit të Muhamet Shalës, që objektin ia ktheu Predrag Lekiqit.

**Esat Kelmendi** – Konsideroi se Universiteti i Prishtinës nuk e ka kontestuar asnjëherë dhe as nuk ka ngritur ndonjë padi kundër Muhamet Shalës. Ai mendonte se kjo çështje i takonte gjykatës ose Drejtorisë për Çështje të Urbanizmit dhe të Planifikimit Hapësinor. Kanë qenë të ndërtuara 33 objekte, por pjesa e jashtme e tyre nuk ishte e renovuar. Kemi kërkuar nga HABITAT-i që 33 objektet e uzurpuara të liroheshin. Këtu nuk bëhet fjalë për Muhamet Shalën. Mendoj se Universiteti nuk ka të drejtë të japë banesa as për personelin e UP-së, edhe pse kemi kërkuar që prona që është në shfrytëzim të Universitetit t'i kthehet dhe të menaxhohet prej tij. Mirëpo deri tash nuk kemi pasur përgjigje pozitive.

**Naim Rrustemi** – Vuri në pah se rasti i Muhamet Shalës ka prekur një temë shumë të rëndësishme. I pyeti përfaqësuesit e Rektoratit dhe përfaqësuesit e

Agjensionit Kosovar të Pronës: “A ka tendenca të bëhet shpronësimi, të merret prona dhe nga Rektorati të kthehet në emër të individëve? A jeni të njoftuar se në pronën e Universitetit janë ndërtuar objekte ilegale banimi? Për se të dallohej profesori nga të tjerët?”

**Beshir Islami** – Vuri në pah se rasti i profesorit dallohej, sepse kishte pasur fatin të hynte në një banesë, që nuk ka qenë e privatizuar. Atë nuk mund ta blinte nga serbi edhe sikur të kishte mundësi, sepse nuk kishte të drejtë, përderisa nuk ishte e privatizuar. Sa i përket tokës, ajo nuk ka qenë objekt shqyrtimi. Ai që jepte tokën, e jepte të ndërtohej objekti. Atij që jepte tokën, komuna nuk mund t’ia merrte përderisa nuk i ndërrohej destinimi, nuk mund t’ia merrte. Përgjigje mori nga përfaqësuesi i Universitetit të Prishtinës

**Sanije Alijaj** – Theksoi se Universiteti nuk është në gjendje ta mbrojë vendimin e vet dhe konsideron se ekzistojnë çështje të padefinuara. E pa të nevojshme që këto çështje të shtrohen në njërën nga seancat plenare të radhës, në mënyrë që të zgjidhen problemet.

**Drita Maliqi** – Pasi dëgjoi me vëmendje procesin e zhvillimit të debatit kërkoi sqarim nga të ftuarit, se kush jeton tani në ato banesa?

**Beshir Islami** - U përgjigj se në këtë pronë pretendon se ka të drejtë Predrag Lekiqi.

**Vezira Emrush** - Theksoi se bëhet fjalë për një çështje voluminoze, që ka të bëjë me pronën. Më tutje foli për mënyrën si është dhënë për shfrytëzim të përkohshëm nga HABITAT-i. Ishte e mendimit se ankuesi e ka fituar të drejtën e pronësisë së banesës dhe askush nuk ka të drejtë t’ia mohojë atë, nga se edhe më parë kjo fushë rregullohej me ligj të veçantë.

**Ibrahim Makolli** – Tha se në mbledhjen e kaluar e kam theksuar, por prapë po e përsëris: “Pra, në këtë rast konkretisht flitet për dy çështje: a është fjala për shpronësim të tokës apo për rast individual? Pra, pse ky njeri, nuk ka mundur të merrte banesë? Nëse është tjetërsuar prona në mënyrë të padrejtë, nuk është bërë shkelje ndaj tij, sepse fjala është për tjetërsim të pronës, që është i kundërligjshëm. Nëse veprimi për ta tjetërsuar pronën është i ligjshëm, atëherë mund të flasim për shkeljen e së drejtës së profesorit.

**Nerxhivane Dauti** – Kërkoi së pari të dallohet e drejta e shfrytëzimit nga e drejta e pronësisë, sepse ky dallim është thelbësor. Duke shtuar se është bërë uzurpimi i një numri të madh të këtyre banesave, pyeti: “Personat që i blejnë këto banesa, a marrin fletëposedim dhe a kanë fletëposedim ata që banojnë në to?”

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv, që u zhvillua nga të pranishmit, lidhur me këtë pikë, u konstatua se çështja e ngritur, nuk bie në fushëveprimin e Komisionit, prandaj lidhur me këtë u nxor ky

## Përfundim

*Komisioni vendosi që në një të njërit nga mbledhjet e radhës të nxjerrë rekomandime përkatëse të dalë nga dy mbledhjet e zhvilluara dhe njëkohësisht lidhur me to të njoftohet ankuesi.*

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i letrës së bardhë: “Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë”, që bashkë me rekomandimet t’i dërgohen Komisionit Funkcional.**

**Kryesuesi** - E konsiderojmë shumë të rëndësishëm këtë dokument, pasi do të hapen rrugë dhe sigurohen fusha të nevojshme për përmbushjen e nevojave imediate. Për shkak të statusit të parregulluar, Kosova nuk ka pasur qasje në fondet ndërkombëtare. Me miratimin e këtij dokumenti krijohet mundësia e vjeljes së fondeve ndërkombëtare të dedikuara për fushat e caktuara. Kjo nismë ka për qëllim ta vërë në diskutim angazhimin e Kuvendit të Kosovës për një shoqëri më përfshirëse, kohezive dhe të begatshme.

**Naim Rrustemi** - Tha se vërejtjet që janë në G P do të inkorporohen.

**Drita Maliqi** – Propozoi të formohet një grup pune që do t’i nxirrte rekomandime dhe do t’i plotësonte në segmente që i përkasin fushës së veprimtarisë së Komisionit.

Me diskutim në këtë pikë kontribuoi Vezira Emrush.

Si konkludim i përgjithshëm doli se vërejtjet eventuale do t’i drejtohen hartuesit të dokumentit - NDI-së.

### 4. Të ndryshme

**Drita Maliqi** – I propozoi Komisionit që sërish të kërkojë nga Qeveria e Kosovës të përshpejtohet Projektligji për pensionet dhe për personat e pagjetur. Propozimin e mbështeti, sepse kjo fushë ka mbetur pa infrastrukturë ligjore dhe ka nevojë që këto kategori të jenë të mbrojtura me ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00.

**Kryetari i Komisionit**

---

Ismet Beqiri